

ESMERALDA PATOSHI (SEFA)

**RRETH NJË TIPOLOGJIE KLASIFIKUESE TË LIDHËZAVE TE
ÇETA E PROFETËVE PËRQASUR ME FJALORIN E GJUHËS SË
SOTME SHQIPE (1980-2002)**

I. Tipet e lidhëzave nga pikëpamja e prejardhjes dhe e ndërtimit të tyre.

Nga pikëpamja e prejardhjes, lidhëzat që dalin te “Çeta e Profetëve” do t’i ndajmë në: 1- lidhëza të parme (d.m.th. që nuk rrjedhin prej pjesësh të tjera të ligjëratës) dhe 2- lidhëza të prejardhura (d.m.th. që janë formuar prej pjesësh të tjera të ligjëratës a prej fjalësh të tjera) Lidhëza të parme janë *e, dhe, edhe, ma, po*. Këto lidhëza janë në përdorim edhe sot, me përjashtim të lidhëzës kundërshtuese *ma* që ka dalë nga përdormi. Lidhëza *ma* pranohet si huazim nga italishtja *Ma* “*por*”. Të gjitha lidhëzat e parme morfologjikisht janë fjalë të thjeshta. Lidhëzat e prejardhura te Bogdani janë më tepër se të parmet dhe për nga pikëpamja e ndërtimit paraqiten si: a) të thjeshta, b) të përbëra c) lokucione. **Lidhëzat e thjeshta** janë gati të gjitha me burim përemëror. Ndër to dallohen dy grupe **a₁**) lidhëza që gjenetikisht lidhen me ndajfolje përemërore dhe që duket se janë mjaft të vjetra në gjuhë: *ku, kur, a₂*) lidhëza të formuara nga trajta rasore të ngurosur të përemrave pyetës e lidhorë, *që, qish, sa, se*. Me burim jopëremëror në këtë kategori lidhëzash janë; **veçuesja** a, që vjen nga pjesëza pyetëse *a, ndjerë*, që është njëkohësisht dhe parafjalë. Përdorimi mjaft i kufizuar i kësaj fjale si lidhëz, në krahasim me përdorimin e saj si parafjalë, është një provë që tregon se lidhëza ka dale nga parafjala dhe jo anasjelltas. **Lidhëzat e përngjitura** ndahen sipas natyrës së fjalëve që hyjnë në përbërjen e tyre. Ato mund të ndahen në: **b₁**- lidhëza që kanë si fjalë të dytë një nga lidhëzat e thjeshta përemërore (*sa, se, si*) dhe **b₂**- lidhëza të formuara pa pjesëmarrjen e ndonjë lidhëze përemërore. Po të marrim parasysh edhe fjalën e parë të përngjitjes, në grupin e parë dallojmë këto nënndarje të mëtejshme: lidhëza që kanë fjalë të parë një lidhëz të thjeshtë: *ose, porsì*; lidhëza që kanë si fjalë të parë një parafjalë: *mbasi, përse, përse*; lidhëza që kanë si fjalë të parë një ndajfolje: *veçesë*. Në grupin e dytë (lidhëza të formuara pa pjesëmarrjen e ndonjë lidhëze përemërore) hyjnë *as, mos e ndo*. Dy të parat kanë të përbashkët elementin e dytë, që nuk është gjë tjetër veçse pjesëza e mohimit *s*, por ndërsa *as* shërben vetëm si lidhëz, *mos* është një pjesëz mohimi që, duke u përsëritur para gjymtyrësh emërore të bashkërenditura, ka kaluar në lidhëz me kuptimin “*as*”. Lidhëza *ndo*, siç mund të kuptohet lehtë, është formuar nga përngjitja e lidhëzës kushtore në me

foljen **do**, që sipas Hahnit, Meyerit e Kamardës është trajta e vetës së dytë të foljes **dua**.

Klasifikimi i lidhëzave sipas prejardhjes

Pra, nga pikëpamja e prejardhjes së tyre edhe lidhëzat mund të ndahen në:
a- *lidhëza të parme* b- *lidhëza jo të parme*. Siç thashë edhe më lartë lidhëza të parme që gjenden në veprën e Bogdanit janë: *as, dhe, e, edhe, o, ose, po, ma* etj. Këto nuk kanë lidhje të gjalla fjalëformuese me ndonjë fjalë tjetër¹. Lidhëza jo të parme janë e gjithë pjesa tjetër. Ato mund t'i ndajmë në tri grupe:

1- Në grupin e parë grupin e parë lidhëza të formuara me konversion nga pjesë të ndryshme të ligjëratës. Në këtë grup hyjnë lidhëzat: *qi(që), sa e se*, të cilët kanë dalë nga përemrat përkatës lidhorë e pyetës; lidhëzat *ku, kur, veç*, që kanë dalë gjithashtu nga ndajfoljet përkatëse².

Lidhëza **qoftë** që ka dalë nga trajta e vetës së dytë e të tretë njëjës e dëshirores së foljes jam, lidhëza veçuese **a**, që vjen nga pjesëza pyetëse **a**. Në këtë kategori më të rëndësishmet janë lidhëzat përemërore e ndajfoljore, të cilat kanë një semantikë mjaft të pasur dhe marrin pjesë në formimin e shumë lidhëzave.

2- Në grupin e dytë lidhëza të formuara nga përngjitja e dy fjalëve të veçanta. Sipas llojit të fjalëve që marrin pjesë në përbërjen e tyre, lidhëzat e përngjitura mund të ndahen më tej në këtë mënyrë:

a) elementi i dytë është lidhëz (zakonisht nga lidhëzat e thjeshta *sa, se, si, që*, etj.), ndërsa i pari mund të jetë gjithashtu: - lidhëz: *posa, posi, kurse, veçse*. P.sh. lidhëza *sikurse*, në përbërjen e saj ka tri lidhëza të thjeshta, është formuar nga lidhëza e përngjitur *sikur* dhe nga lidhëza *se*

- parafjalë: *mbassi (mbas+si) ndërsa, përveçse*.
- parafjalë + përemër: *megjithëse (me+gjithë+se)*
- formë foljore: *meqënëse*

b) elementi i parë lidhëz, ndërsa i dyti mund të jetë:

- përemër: *siç (si+ç)*
- trajtë foljore: *ndo (në+do)*

c) asnjë prej elementëve përbërës nuk është lidhëz: *gjithëherë*.

Siç shihet nga paraqitje e mësipërme, shumica e lidhëzave të përngjitura kanë si element të dytë një lidhëz të thjeshtë. Në këtë grup në mjaft raste edhe elementi i parë është gjithashtu një lidhëz.

3- Në grupin e tretë lokucione lidhëzore

¹ Lidhëza *as, ose* historikisht kanë dalë nga përngjitja e dy fjalëve të veçanta (*a+s, o+se*), por nga pikëpamja e gjuhës së sotme ato shihen si fjalë të parme.

² Kanë kaluar në lidhëza me anë të konversionit edhe ndajfoljet e përngjitura *sado, sido* etj., por ato zakonisht ndiqen edhe nga lidhëza *që*, duke formuar lokucion.

Këto janë të shumta dhe ndërtimi i tyre është i larmishëm, sidomos te Bogdani. Në përbërjen e tyre lokucionet lidhëzore marrin pjesë emra e forma foljore, çka nuk vihet re te lidhëzat e përngjitura. Në çdo lokucion ka rregullisht një lidhëz a një fjalë lidhëse. Në shumicën e rasteve lidhëzat që marrin pjesë në formimin e lokucioneve, janë *se* dhe *që*, më rrallë edhe *ku*, *kur*, *në*, *po*. etj.

Këto lidhëza mund të bashkohen:

- me një emër me parafjalë
- me një formë foljore, së cilës i duhet t'i prijë një lidhëz tjetër
- me një lidhëz tjetër
- me një pjesëz

Një lloj të veçantë të lokucioneve lidhëzore përbëjnë lidhëzat dyshe. Gjymtyrët e tyre nuk ndodhen pranë njëra-tjetrës, por qëndrojnë para secilës nga të dy fjalët a fjalitë që lidhin. Këto lokucione mund të përbëhen:

- prej së njëjtës lidhëz që përsëritet: *ndo...ndo; qoftë.... qoftë* etj.
- prej dy lidhëzash të ndryshme
- prej lidhëzash e pjesëzash

Fjalët që marrin pjesë në përbërjen e një lokucioni shprehin të gjitha së bashku një kuptim të vetëm dhe funksionojnë si pjesë e ligjëratës. Por shkalla e gramatikalizimit të lokucioneve lidhëzore nuk është e njëjtë. Te disa prej tyre elementët përbërës kanë formuar unitet më të madh kuptimor e shqiptimor, te disa të tjera ato ruajnë njëfarë mëvetësie kuptimore dhe në shqiptim para lidhëzës që ndodhet në fund të lokucionit, ka një farë pauze sado të shkurtër. Ashtu si te lokucionet parafjalore edhe te lokucionet lidhëzore emrat ose foljet që hyjnë në përbërjen e tyre, përdoren në një formë të pandryshueshme. Përveç lidhëzave, si mjete lidhëse në periudhë përdoren edhe përemrat lidhorë e disa ndajfolje lidhore, *si ku, kur*, etj., që quhen edhe fjalë lidhëse. Përveç fjalëve lidhëse në kushte të caktuara sintaksore bëjnë punën e lidhëzave edhe disa fjalë të tjera. Të tilla si pjesëzat pyetëse *a* e *mos*, të cilat në pyetje të zhdrejta shërbejnë për të lidhur fjalinë e varur me kryesoren.

II. Klasifikimi i lidhëzave sipas strukturës morfologjike

Cilado qoftë prejardhja e tyre lidhëzat nga pikëpamja morfologjike mund të jenë fjalë të thjeshta, të përngjitura ose lokucione. Janë fjalë të thjeshta ato që përbëhen vetëm prej një morfeme³. Të tilla janë të gjithë lidhëzat e parme: *as, dhe, e, edhe, o, ose, po, ma*, si edhe lidhëzat që kanë dalë prej fjalësh të thjeshta (përemra, ndajfolje, pjesëza), si: *qi (që), sa, se, ku, kur, si, veç, a*. Janë fjalë të përngjitura lidhëzat e formuara nga përngjitja e dy a më shumë fjalëve të veçanta, si: *posi, posa, sesa, kurse, sikurse, ndonëse, mbassi*. Lokucionet

³ Nga fjala greke morpho = formë. Ajo është njësia më e vogël e kuptimshme, që mund të dallohet në përbërjen e fjalës.

lidhëzore përbëhen prej dy a më shumë fjalësh (të bashkuara në një fjalë), të cilat kanë një kuptim të vetëm dhe kryejnë funksionin e një lidhëze. Prejardhja dhe përbërja morfologjike e lidhëzave lidhen ngushtë me kuptimet e tyre. Lidhëzat e thjeshta, qofshin të parme qofshin të prejardhura janë përgjithësisht më abstrakte dhe shprehin një numër më të madh kuptimesh në krahasim me lidhëzat e përngjitura e lokucionet, të cilat kanë një kuptim leksikor më të qartë e më konkret. Kështu, p.sh., vlera e lidhëzës se (ftilluese, shkakore a krahasore), sqarohet vetëm brenda periudhës ku është përdorur, ndërsa lidhëzat e përngjitura e lokucionet e formuara me pjesëmarrjen e saj si: *sepse*, *meqënëse*, kuptohet menjëherë se janë lidhëza shkakore. Thjeshtësia e përbërjes morfologjike të një lidhëze, si rregull, është në përpjesëtim të zhdrejtë me gjerësinë e sferës kuptimore të saj. Kjo gjerësi e sferës kuptimore të lidhëzave të thjeshta mund të ketë arsye të ndryshme, por në radhë të parë këtu ndikon prejardhja, mosha dhe dënduria e përdorimit. Kështu, lidhëzat e thjeshta me burim përemëror se, që janë më abstrakte, më të shumëkuptimshme se lidhëzat e thjeshta me prejardhje ndajfoljore: *ku*, *kur*, *si*, ose foljore: *qoftë*, për shkak se kuptimi leksikor i ndajfoljeve e i foljeve është i përcaktuar, ndërsa kuptimi i leksikor i përemrave është i papërcaktuar. Lidhëzat me burim ndajfoljor shprehin marrëdhënie të caktuara semantiko-sintaksore: marrëdhënie vendore, kohore, krahasore, shkakore etj., ndërsa lidhëzat me burim përemëror *që* e *se* mund të shprehin secila shumë lloje marrëdhëniesh. Ato mund të shërbejnë si për të shprehur vetëm marrëdhënie varësie sintaksore, pa kurrfarë semantike, ashtu edhe për të shprehur lloje të ndryshme marrëdhëniesh semantiko-sintaksore. Lidhëzat e përngjitura e sidomos lokucionet shprehin zakonisht një kuptim të caktuar, i cili shumë herë buron nga vetë kuptimi i fjalës emërtuese që bën pjesë në lokucion. Shumica e lokucioneve lidhëzore janë formime relativisht të reja, prandaj nuk mund t'i hasim te vepra e Pjetër Bogdanit.

Po marr disa shembuj nga vepra për të demonstruar klasifikimin e lidhëzave sipas prejardhjes së tyre duke u ndalur te lidhëzat kohore në veprën Çeta e Profetëve:

Lidhëzat kohore

Kjo kategori lidhëzash ashtu si edhe në shqipen e sotme është mjaft e pasur, më e pasur se çdo kategori tjetër lidhëzash. Te vepra e Bogdanit na dalin këto **lidhëza kohore të thjeshta**: *kur*, *ndjerë*, *sa*, *se*, *si*, *qysh*; **lidhëza të përngjitura**: *mbassi*, *mbasandaj*, *gjithëherë* si dhe **lokucione kohore**: *atëherë* *kur*, *qi kur*, *sado herë*, *ma mbasi*, *kur ndëmosë herë*. Lidhëzat kohore shërbejnë për të ndërtuar fjali që shprehin lloje të ndryshme marrëdhëniesh kohore. Kjo periudhë quhet e tillë pasi tregon kohën kur ndodh veprimi, ngjarja e fjalisë kryesore.

1- Lidhëza *kur* është përdorur 239 herë dhe ka dëndurinë më të madhe se të gjithë llojet e tjera të lidhëzave kohore. Kjo lidhëz e tregon kohën në

mënyrë të përgjithshme, pa e konkretizuar raportin kohor midis fjalisë kohore dhe fjalisë drejtuese të saj. Konkretizimi i këtij raporti del jo nga kuptimi i lidhëzës, po nga marrëdhënia që ekziston midis foljeve-kallëzues të këtyre fjalive. Ky raport mund të jetë dy llojesh: raport njëkohësie e raport suksesioni kohor. Njëkohësia mund të jetë a) e plotë, b) e pjesshme. Njëkohësi të plotë ka në ato raste kur tregohet se dy veprime përputhen në pikëpamje të kohës gjatë gjithë zhvillimit të tyre. P.sh.: *E ka me kjanë të pamit e gjithë kafshëvet posi fjalëtë e librit shenjuem të sillënë kur të japënë ati qi di letërë, ... Ishinë rrjedhunë 2463 vjet së Saint së fill së shekullit, e 1597 parë Gjezu Krishtit, kur Zotynë, për të nxjerrë popullin e vet robijet së Misirit, ... Tue kjanë Jakobi afërë mortisë, thirri bijt e vet, t'sijet për tu kallëzue kur kish për të ardhunë Mesia tha: ...ashtë fjala e mishënueme ka me kjanë ngushëlluem Regji Krisht, kur të ngjalletë e të rrij... Depëtuenë duert e mia e kambët e mia, kur kryqësuenë Krishnë. Me shumë mëndyrë kje përmetuem Krishti Mesi; ma tepërë Mojsesit Eksodi 33, kur tha Hyji, ... Nji dorë janë si përronjë të ndë rend të shijënavet, kur lymi hjek mbas veti lisa, ...e përse ish ndë majë të malit gjithë e shifinë kur shëkronte idhujet..., Izaia ngushëlloj rejnë Exekjel, kur regji Senakarib rrethoj Jeruzalemë...; Ma ndëpër uratë të Izaisë, qi ishte ndë gjytet, gjajnë ditënë gurrënë thatë, e natënë vejnë, kur vejnë të gjytetasitë...; Kur regji Senakarib rrethoj gjytetn e Jeruzalemit, të gjytetasitë drojnë ditënë; ...posi xgidhetë se kingji bij mbë gjunjë Saint Françeskut kur çonte mesë; Prej Jeruzalemi, do me thanë kur apostujitë e dishipujitë, forçuen Rrshajeshit prej Shpirtit S...;*⁴

Po të vëmë re, në këto raste foljet-kallëzues të fjalisë drejtuese e kohore janë në të njëjtën kohë, d.m.th. në të tashmen ose në të shkuarën. Njëkohësi e pjesshme ka në ato raste kur tregohet se dy veprime (me shtrirje kohore të pabarabartë) përputhen pjesërisht gjatë kohës së zhvillimit të tyre. P.sh.: *Për nji si e mbërrini moti, e ajo kohë e lume kur kishte vum rok biri i Tinëzot... Aso koheje kur dita e nata mbë terezi janë të njimendë ndë 25 dit ndë mars...; e lume kjeshë me kjanë kur të munë shërbenje si...*⁵

Suksesioni kohor ka në ato raste kur është fjala për dy veprime që pasojnë njeri-tjetrit. Në këtë mes veprimi i shprehur në fjalinë kohore ndodh para veprimit të fjalisë drejtuese. P.sh.: *Kur vë përpara diellit vogëlohet, kur e ndjek rritetë batiça e detit prej soje. Ma kur e vë përpara, i thonë Ylli i Dritësë, kur e ndjek diellnë, i thonë Ylli i Mbramjesë. Kur hin ndërmjet Veneri e Gjovi, xbutet lëngimi i tinaj. Kur regji Senakarib rrethoj gjytetn e Jeruzalemit, të gjytetasitë drojnë ditënë..., Kur të shkojsh ndëpër ujëna shembëllen dijenë Ashtu ende duhetë me vum roe sakrificin e Abramit, kur desh me sakrifikuem të birr e vet Izaknë, ...Kur skribëtë e farazejtë lypnë*

⁴ P. Bogdani. ÇP. I, f. 82-120.

⁵ P. Bogdani. ÇP. II, f. 1-12.

*shenje prej qiellshit, u përgjegj Krishti:....; Prashtu i S. Gjo. kur e pa ndë shkretëtiti tha:....; Kur Abrami vpte ndë dhe të Misirit me kërkue shembëlltyrë ende kje. Kur vote Jozefi e Maria ndë Betlemt me paguem haraçinë, veçë... Kur djalli nxiti Evënë kje ndë fëtyrë të gjarpënit...*⁶

Nga shembujt e marrë më sipër duket qartë se foljet-kallëzues në fjalinë kohore e drejtuese mund të jenë të dyja në të njëjtën kohë. Fjalja kohore me lidhëzën kur rri përgjithësisht para fjalisë drejtuese, por mund të rri edhe pas saj. Disa shembuj të tjerë për këtë lidhëz janë: *Të zanët e diellit ashtë atehere kur Çorp. Hanësë qendrat ndër ne e ndër diellinë,...; Të zanët e dritësë hanësë ashtë atehere kur ndër diellinë e hanënë hin qendrat dheu....; Tha, nukë kam xgedhunë ma tej, e me këtë fjalë ende pruhej kur e pëvetënte:....Jo tepërë keq kish me kjanë kur të kidhinë thanë se Atlanta regji iMauritaniesë, Përse shofëmë ndënatjet kur hin me u xbeluem mbë këtë shekullit tanë....; Ati qi i xbelohetë kur len dielli:....; Retë bahenë kur forçet së diellit ngrihenë nalt avulli ujënash, bërrakash e viseshit së njomash, e bahenë së nalti.*⁷

Lidhëzat e përngjitura

Te vepra e Pjetër Bogdanit gjenden këto lidhëza të përngjitura: *mbassi, mbasandaj e gjithëherë.*

1- Lidhëza *mbassi* që ka kuptimin sinonimik me lidhëzën si është përdorur 81 herë. Me anë të kësaj lidhëze veprimi i fjalisë drejtuese e kohore duket sikur ka një kufi të dallueshëm mirë ndërmjet tyre, ndryshe nga veprimi në fjalinë kohore të ndërtuar me lidhëzën si, ku veprimi është më i lidhur. Në periudhën me fjali kohore të ndërtuar me lidhëzën *mbassi* veprimi i fjalisë drejtuese vjen pas veprimit të fjalisë së varur kohore. Fjalja kohore me këtë lidhëz e ka vendin zakonisht para fjalisë drejtuese, por mund të rri edhe pas saj. Disa shembuj të kësaj lidhëze me kuptimin kohor janë: *...kjenë mbushunë mirëfilli, mbasi hipi mbë qiellt, posi shkruem Euzebi. Mbasi hini ndë kishë, pa venduem tregëtarëtë....; Mbasi pat kërkue shumë vise ndëpër Jude gjithëherë me një shumicë të madhe gjindje, e të sëmute qi e ndiqinë për tu shëndoshunë, ndëvonë e mbërrini ndaj....; ...tue shkruem aj gjithë atë natë ndë uratë, mbasi duel drita....;*

*Mbasi i pat xgedhunë, zdripi Shëlbuesi prej malit me apostujët....; Vote Shëlbuesi, e mbasi kjenë ndenjune mbë tryesë hini një grue e përmpkatënueme....; Mbasi u da Jezu Krishti shtëpijet së Farizeut i pruna përpara një nieri të djemënuem. Mbasi lau Jezu Krishti kambëtë, muer petëkat e vet...*⁸

2- Lidhëza *mbasandaj* është përdorur në vepër 19 herë si më poshtë: *Mbasandaj erdhë dy të verbëtë tue u lutunë Jezu Krishtit, a të i ndritën.*

⁶ P. Bogdani. ÇP. I, f. 12-67.

⁷ P. Bogdani. ÇP. I, f. 24-37.

⁸ P. Bogdani. ÇP. II, f. 51-93.

Pakëzë mbasandaj u godit Jezu krishti ndë Jeruzalemt tue predikuemmbë zakon. E pakëzë mbasandaj tue u vum kundruell me xhudhit, thotë: ...; Erdhnë mbasandaj saduçejtë, të sijtë nukë epeshinë ndë të ngjallunit...; ...po banke luftë kundër shintënet, e po mujtëke, e pakëzë mbasandaj thotë, e ka me dërmuem shenjtënit'e t'naltit, ...E pakëzë mbasandaj tue me u vum kundrell me gjudhit...; ...kje një madh gazëment i tyne, e panë pakëzë mbasandaj shëlbuesinë se po avitej...; Mbasandaj prej Jeruzalemit i shpu me vetëhe prej Jeruzalemi ndë Betaniet; ...e të paletërë s'i mbajtinë për asgja, mbasandaj tue ndjem se po flisinë kafshë fort t'urta...; E mbasandaj e ka me dhanë mrekuilli mbë qiellt e mbë dhet, gjaknë e zjarrë e avullin'e tinit.⁹

3- Lidhëza gjithëherë është përdorur te Bogdani 7 herë si më poshtë: ...tue urdhënuem gjithëherë me vum enëtë ngiat me ujë për tu lam ende tu ngranë bukë... Kanë me ardhunë rreth Gjytetsë e kanë me pësue uni posi qentë, e gjithëherë ma fort dëshërojnë;...ndo Sion, ndo veshti Tinëzot, gjithëherë mirretë vesht për Kishë të feshimet Krishtit...; ...psikur t'ish ma harruem mbë shekullit, ma gjithëherë prej Sinëzot ruejtunë për të mbëdha posi ka me u thanë afërë. Gjithëherë bante çiliçinë, o thes mbë vetëhe, mu për urdhëni të Tinëzot...¹⁰

Lokucionet kohore

Lokucionet kohore që përdoren te Bogdani janë:atëherë kur, qi kur, që sa, sado herë, ma mbasi, kur ndëmosë herë. Këto lokucione në vepër përdoren pak në shembuj të tillë si:Atëherë kur Jakobi tue kthiem prej Masopotamie u muer përbalçazë me engjëllit...; ...se me mot kishte për tu bam regji i Izraelit, atëherë kur Samueli e lyejti për urdhëni të tinaj...; ...veçë ju lutshë të më shtampohej libri, ashtu qi kur të kthenje prej dheut sinë të keshë një qiri ndezunë n;dorë...; Nukë kish me kjanë posi një tjetër nabukodonozor madhështuer Perëndia i Turqisë kur ndëmosë herë herë të mos vinte roe ndë vetëhe të madht'e vet mbë këtë jetë...; Përse mpkateve mortare jo veçë u përket mundi amëshueshim, ma mbasi të jenë xgidhunë mpkatet me rëfim...; Ashtu qi gjithëherë të kish përpara syvet qish kishte vjerrë, për të kjanë e anëkuem fajt e tyne; ...qi janë të thatitë, të njomëtë, të ftofëtitë e të nxetitë, ndëpër të sijtë vjen mortaja sado herë njana së mëndyrësh mundën tjetërën. Këjo sado herë qiaj i urti letërar kthente ndë shtëpit'vet, e prit me një furi...¹¹

Po marr edhe disa shembuj nga lidhëzat që përdoren edhe sot në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, në këtë mënyrë shohim se si kanë ndryshuar ato apo se si kanë evoluar në kohë. Disa kanë mbetur të pandryshueshme, disa lidhëza janë zhdukur e një pjesë kanë ndryshuar duke sjellë forma të reja por me kuptime të njëjta.

⁹ P. Bogdani. ÇP. II, f. 48-156.

¹⁰ P. Bogdani. ÇP. I, f. 82-118.

¹¹ P. Bogdani. ÇP. I, f. 6-102.

1- Lidhëza kur përdoret për të lidhur midis tyre fjali të varura, që shprehin marrëdhënie të ndryshme kohore ose një fjali kryesore me një fjali të varur, e cila tregon një veprim që kryhet pa përfunduar një tjetër. Përdoret në fjalitë thirrmore kur shprehin habi¹².

2- Lidhëza mbasi-pasi¹³

3- Lidhëza pasi përdoret në fjali të varur kohore, veprimi i së cilës kryhet përpara veprimit të shprehur nga fjalia kryesore¹⁴.

4- Lidhëza sapo përdoret në krye të një fjalie të varur kohore që tregon se diçka kryhet fill para veprimit të shprehur në fjalinë kryesore, që në çastin kur etj.¹⁵

5- Lidhëza qëkurse¹⁶

6- Lidhëza gjithashtu –sa herëqë, kurdoherë që, Gjithashtu shihe te nevojshme¹⁷.

¹² Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë, 2002, f. 653.

¹³ Po aty, f. 744.

¹⁴ Po aty, f. 938.

¹⁵ Po aty, f. 1161.

¹⁶ Po aty, f. 1075.

¹⁷ Po aty, f. 440.